



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2827/6 prot.

Datë, 31.10.2025

V E N D I M
Nr. 1569/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.10.2025 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomikë “XHERI’S COMPANY” SHPK nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar- Mallra”, me nr. REF-64037-10-08-2025, me objekt “Materiale për ndriçimin e rrugëve të Njësive Administrative”, me fond limit 6 150 000 (gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të mësipërme

Ankimues:

Operatori ekonomik “XHERI’S COMPANY” SHPK, me Nipt. M42725802A dhe adresë Rr.Hajdinet, ndërtesa 1, Hyrja 1, Luz I Vogël, Kavajë

Autoriteti Kontraktor:

Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza”, Nr. 492, Kamëz

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimes dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të 3(tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.10.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar- Mallra”, me nr. REF-64037-10-08-2025, me objekt “Materiale për ndriçimin e rrugëve të Njësive Administrative”, me fond limit 6 150 000 (gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz.

II.2. Në datën 13.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5933 dhe me nr. 2827/2025 prot., datë 13.10.2025 e operatorit ekonomik “XHERI’S COMPANY” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë:

“ Ne daten 09 tetor 2025 Shoqeria jone u njoh ne dokumentat standarte te procedures me objekt i Materiale për ndriçimin e rrugëve të Njësive Administrative” te publikuar nga Autoriteti Kontraktor i Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamez”. Pasi u njohem me dst konstatuam se ato ishim ne kundershtim me legjislacionin e prokurimeve publike dhe shkelin haptazi parimet e tij, sic eshte dhe nje nga parimet me kryesore, konkurenca e ndershme dhe e barabarte per te gjith Operatoret ekonomik. Autoriteti Kontraktor Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamez ka ngushtuar në mënyrë artificiale konkurrencën e barabart.

Shoqeria jone ka pyetur ne te gjitha dyqanet te cilat tregetojne materiale elektrike per Shtylla metalike ndricimi H=8.8M me Spesori I shtyllës: 3.6 mm ? 10 % dhe pergjigja ka qene se ne Republiken e Shqiperis si dhe ne shtetet fqinj kjo shtylle me keto permasa nuk tregtohet me dhe nuk ka sasi.

Autoriteti kontraktor ku eshte bazuar dhe ka kerkuar shtylla ndricimi me keto permasa?!

A ka realizuar nje studim paraprak te tregut sipas nenit 35 te LPP-se per te orientuar me mire OE apo qellimi ka qene te favorizojë ndonje OE te caktuar duke penguar pjesemarrjen e gjere ne kete procedure prokurimi?

Verejme qe per cdo pjese mbeshtetes te shtyllet kerkohen qe materialet te jene te pajisura me Iso te caktuara. Ne kete rast mjaftojn qe keto pjese te materialeve te jene te pajisura me Deklaratë/«ertifikatë Konfirmiteti CE ose raportet e testimit të lëshuara nga ente çertifikues të akredituar dhe jo me ISO duke ngarkuar OE dhe duke e penguar pjesemarrjen e tyre.

Sa me siper kerkojm te ulen permasat e shtyllave te ndricimit dhe tehiqen ISOT e kerkuar per pjeset mbeshtetese.

Se dyti Keto pajisje dhe materialet e kerkuara duhet te kerkohen me Deklaratë/«ertifikatë Konfirmiteti CE ose raportet e testimit të lëshuara nga ente çertifikues të akredituar dhe jo me ISO duke ngarkuar OE dhe duke penguar pjesemarrjen e tyre.”

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 1138/1 prot, datë 14.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2827/1 prot, datë 15.10.2025 (ardhur nëpërmjet sistemit elektronik), dhe nr. 2827/2 prot, datë 16.10.2025 (ardhur nëpërmjet shërbimit postar) është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues (vendimi i KSHA-së) nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur pranim pjesërisht të saj dhe konkretisht:

“Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pasi analizoi përmbajtjen e dokumentave të tenderit, specifikimet teknike dhe kërkesat e vendosura në DST, vlerësoi të arsyeshëm pretendimin e operatorit ekonomik duke vendosur ndryshimin e specifikimeve teknike si më poshtë:

Shtylla metalike ndriçimi H=8.8M, e zinguar në të nxehtë sipas standartit UNI EN ISO1461. Do të hiqet kërkesa për paraqitjen e EN ISO1461..

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron....”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “XHERI’S COMPANY” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, nr. 1138/1 prot, datë 14.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2827/1 prot, datë 15.10.2025 (ardhur nëpërmjet sistemit elektronik), dhe nr. 2827/2 prot, datë 16.10.2025 (ardhur nëpërmjet shërbimit postar) është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues (vendimi i KSHA-së) nga ku rezulton se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur pranim pjesërisht të saj dhe konkretisht:

“Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pasi analizoi përmbajtjen e dokumentave të tenderit, specifikimet teknike dhe kërkesat e vendosura në DST, vlerësoi të arsyeshëm pretendimin e operatorit ekonomik duke vendosur ndryshimin e specifikimeve teknike si më poshtë:

Shtylla metalike ndriçimi H=8.8M, e zinguar në të nxehtë sipas standartit UNI EN ISO1461. Do të hiqet kërkesa për paraqitjen e EN ISO1461..

Për sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron...”.

III.1.1. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.2. Neni 114 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të

punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i vendimit të autoritetit kontraktor, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim pjesërisht të

ankesës së operatorit ekonomik “XHERI’S COMPANY” SHPK, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr.1033 prot., datë 22.04.2025, të operatorit ekonomik “XHERI’S COMPANY” SHPK

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “XHERI’S COMPANY” SHPK përsa i përket e specifikimeve teknike të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi me pretendimin se *Shoqeria jone ka pyetur ne te gjitha dyqanet te cilat tregetojne materiale elektrike per Shtylla metalike ndriçimi H=8.8M me Spesori I shtyllës: 3.6 mm ? 10 % dhe pergjigja ka qene se ne Republiken e Shqiperis si dhe ne shtetet fqinj kjo shtylle me keto permasa nuk tregtohet me dhe nuk ka sasi.*

Autoriteti kontraktor ku eshte bazuar dhe ka kerkuar shtylla ndricimi me keto permasa?!
A ka realizuar nje studim paraprak te tregut sipas nenit 35 te LPP-se per te orientuar me mire OE apo qellimi ka qene te favorizojë ndonje OE te caktuar duke penguar pjesemarrjen e gjere ne kete procedure prokurimi?,, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, kemi të bëjmë më shumë me kërkesë për sqarim për të cilin autoriteti kontraktor e ka sqaruar dhe nëpërmjet vendimit nr.1138 prot., datë 14.10.2025. Sa më sipër komisioni gjykon se ky sqarim është ezauruar si në DST ashtu dhe në vendimin nr.1138 prot., datë 14.10.2025 ku specifikimi për këtë artikull nuk është fiks por me diapazon ±.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2024, datë 13.10.2024 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos

1. Të mbyll çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “XHERI’S COMPANY” SHPK nga autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar- Mallra”, me nr. REF-64037-10-08-2025, me objekt “Materiale për ndriçimin e rrugëve të Njësive Administrative”, me fond limit 6 150 000 (gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë, pa TVSH, parashikuar

për t'u zhvilluar në datë 20.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Sherbimeve Publike Kamëz.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE, sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "XHERI'S COMPANY" SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

